



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË

**BURSA PËR STUDIME UNIVERSITARE DHE PASUNIVERSITARE NË
SLLOVAKI, VITI AKADEMIK 2019-2020**

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Sllovakinë në fushën e arsimit, Qeveria e Republikës së Sllovakisë ofron bursa për studime universitare dhe pasuniversitare për shtetas shqiptarë, të cilët dëshirojnë të studiojnë në institucionet publike të arsimit të lartë të Republikës së Sllovakisë për vitin akademik 2019-2020 në programet e studimit në vijim:

1. Trajnimi i mësuesve dhe shkencat e edukimit;
2. Biznes dhe administrim;
3. Ekologji dhe shkenca mjedisore;
4. Arkitekturë dhe inxhinieri;
5. Inxhinieri ndërtimi, teknologji, manufakturë dhe komunikim;
6. Bujqësi;
7. Pylltari;
8. Menaxhimi i burimeve ujore.

Kandidatët e interesuar për këto bursa studimi duhet të aplikojnë online në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit, Shkencës Kërkimit dhe Sportit të Sllovakisë: <https://www.vladnestipendia.sk/en/application>, si dhe të dërgojnë me postë në Drejtorinë e Integritimit, Koordinimit, Marrëveshjeve dhe Asistencës në Ministrinë e Arsimit Sportit dhe Rinisë deri më datë **26 Prill 2019**, dokumentet e mëposhtme:

Për studime universitare Bachelor:

1. Kërkesën për studime universitare, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Diplomën dhe vërtetimin e notave për tre vitet e shkollës së mesme të noterizuara. Ky vërtetim duhet të jetë i firmosur nga Drejtoria Rajonale/Zyra Arsimore e rrethit përkatës dhe nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë;
3. Fotokopjen e faqes së pasaportës me të dhënat e identitetit;
4. Raportin mjekësor;
5. Katër fotografi dokumenti .

Për studime pasuniversitare Master:

1. Kërkesën për studime pasuniversitare, duke specifikuar degën në të cilën kandidati dëshiron të studiojë. Kërkesa të jetë e nënshkruar nga kandidati dhe të përmbajë adresë e-mail dhe numër kontakti;
2. Fotokopjen e noterizuar të diplomës së shkollës së lartë dhe listën e notave;

3. CV-në;
4. Dy letra rekomandimi;
6. Raportin mjekësor;
7. Fotokopjen e faqes se pasaportës me të dhënat e identitetit;
8. Katër fotografi dokumenti.

Kandidatët e përzgjedhur do t'i nënshtrohen vitit përgatitor të gjuhës sllovaqe.

Për një informacion më të detajuar për kushtet e përfitimit të bursës, mënyrën e aplikimit, dhe të përgatitjes së dokumentacionit, ju lutemi referojuni adresave në web-site:

<https://www.vladnestipendia.sk/en/>

<http://www.minedu.sk/scholarships-of-the-government-of-the-slovak-republic/>

DREJTORIA E INTEGRIMIT, KOORDINIMIT, MARRËVESHJEVE DHE ASISTENCËS